



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Nr. 2756/2 Prot.

Tiranë, më 14/06/2013

URDHËR

Nr. 250, datë 14.6.2013

PËR

**AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË PËRFUNDOJNË ME
DIPLOMAT UNIVERSITARE "BACHELOR", "MASTER I SHKENCËVE" DHE
"MASTER PROFESIONAL" TË UNIVERSITETIT "POLIS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007
"Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në "Art dhe Dizajn" dhe "Studime Mjedisore" të universitetit "Polis" në përputhje me vendimin nr. 470 datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë (bashkëlidhur).
2. Akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në:
 - a. "Menaxhim mjedisor urban".
 - b. "Dizajn i aplikuar".në përputhje me vendimin nr. 470 datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
3. Akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare "Master profesional" në:
 - a. "Dizajn urban dhe peizazhi".
 - b. "Dizajn estetik strukturor".
 - c. "Dizajn arkitektonik dhe parametrik".
 - d. "Strehim dhe zhvillim toke".
 - e. "Zhvillim social urban dhe burime njerëzore".
 - f. "Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS".në përputhje me vendimin nr. 470 datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

4. Universiteti "Polis", brenda 6 muajve nga dalja e këtij urdhri, të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
5. Universiteti "Polis", do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të këtyre programeve të studimit të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
6. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Polis".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ


MINISTËR

